

URDHËR
Nr. 6, datë 10.1.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 22, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, datë 28.5.2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të kreut VII, të nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretarit të Përgjithshëm znj. Gelardina Prodani, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fondet buxhetore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm nga data 3.1.2018 deri më 31.12.2018.

3. Urdhri nr. 64/1, datë 5.12.2016, “Për delegim kompetencash” dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhër shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj